



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr. 568/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Adnan Konushevci dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për deputet Anton Shala, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.568/20 e datës 04.03.2021, i paraqitur nga kandidati për deputet Anton Shala, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Vendvotimin 0213C-03R.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.03.2021, ka pranuar një apel Anr.568/2021 nga kandidati për deputet Anton Shala, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, në të cilën pretendohet se pas shpalljes së rezultateve preliminare në qendrën e votimit me numër 0213C/03R në Gjakovë, kandidati me nr.19 ka rezultuar të ketë 35 vota, ndërsa pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga ana e KQZ-së i njëjti posedon vetëm 2 vota të shënuara në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK.

Parashtguesi i ankesës si provë ka bashkangjitur deklaratën e vëzhguesit dhe kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votave në VV 0213C/03R.

Në përgjigjen në apel të datës 04.03.2021, të KQZ-së thekson se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palëve ankuese, në lidhje me ankesën 568, njofton se Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ka përfunduar procesin e punës si dhe futjen e të dhënave, skanimin e materialeve zgjedhore, verifikimi, hetimin e formularëve të përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularët e rezultateve, të kandidatëve FRK, procese këto që mundësojnë evitimin e çdo gabimi teknik dhe jo relevant. Në bazë të Rregullës Zgjedhore, Nr.06/2013, secili formular i rezultateve, para se të filloj të procedohet, i nënshtrohet procesit të auditimit në QNR, gjatë të cilit proces krahasohen votat e subjekteve me votat e

kandidateve. Nga auditimi që i është bërë formularëve të rezultateve, rezulton se ka pasur probleme, të mos shënimet të saktë në kuptimin teknik të votave të subjekteve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Kandidati për deputet Anton Shala, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, brenda afatit ligjor, ka parashtruar Apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në VV 0213C/03R., sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli, me rastin e vendosjes së apelit dhe përgjigjes në apel ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga apeluasi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i apelit se në VV me numër 0213C/03R i njëjti posedon 35 vota.

Në fletëvotimet që janë rinumëruar del se subjekti politik AAK, ka fituar 73 vota të cilat janë shënuar në Formularin e Përputhjes së Rezultateve dhe 2 vota i posedon kandidati për deputet me numër rendor 19 Anton Shala, dhe se të njëjtat vota iu janë shënuar në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRK.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

**Anr. 568/2021 më datën 05.03.2021**

**Kryesues i Panelit**

Faton Ademi



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.